VENDIM
Nr.284, datë 21.4.2010

PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMEVE TË DOKTORATËS, NË FAKULTETIN E INXHINIERISË ELEKTRIKE DHE NË ATË TË INXHINIERISË SË NDËRTIMIT NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË TIRANËS, SI DHE PËR MIRATIMIN E KUOTËS SË PRANIMIT E TË TARIFËS SË SHKOLLIMIT NË KËTO PROGRAME STUDIMI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, 34, 42 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen, në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike, të Universitetit Politeknik të Tiranës, të programit të studimeve të ciklit të tretë, të doktoratës, në inxhinieri elektrike, me tre drejtime:

a) Elektroteknikë, në përfundim të së cilës lëshohet diploma për gradën shkencore "Doktor" (Dr.) në inxhinieri elektrike, me drejtim elektroteknikë.

b) Automatizimi i industrisë, në përfundim të së cilës lëshohet diploma për gradën shkencore "Doktor" (Dr.) në inxhinieri elektrike, me drejtim automatizimi i industrisë.

c) Elektroenergjetikë, në përfundim të së cilës lëshohet diploma për gradën shkencore "Doktor" (Dr.) në inxhinieri elektrike, me drejtim elektroenergjetikë.

2. Hapjen, në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit të Universitetit Politeknik të Tiranës, të programit të studimeve të ciklit të tretë, të doktoratës, në gjeodezi.

a) Në përfundim të programit të studimeve të ciklit të tretë, të doktoratës, në gjeodezi, lëshohet diploma për gradën shkencore "Doktor" (Dr.) në gjeodezi.

3. Këto progame studimi e fillojnë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2009-2010.

4. Kohëzgjatja e këtyre programeve të studimeve të doktoratës është, të paktën, 3 vite dhe përfshijnë edhe 60 kredite për studime të organizuara.

5. Kuotat e pranimit në këto programe studimi, për vitin akademik 2009-2010, janë si më poshtë vijon:

- Inxhinieri elektrike, me drejtimet:

a)	Elektroteknikë	12 kuota;
b)	Automatizim i Industrisë	12 kuota;
c)	Elektroenergjetikë	12 kuota;

- Gjeodezi…… 12 kuota.

6. Nga kuotat e mësipërme caktohet 10 për qind për studentët nga trojet shqiptare jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë dhe administrohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, sipas kërkesave të institucioneve zyrtare të këtyre trojeve.

7. Kuotat e paplotësuara rishpërndahen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

8. Tarifa e shkollimit për këto programe studimi është 200 000 (dyqind mijë) lekë dhe likuidohet për çdo vit të kohëzgjatjes normale, në këste të caktuara nga fakultetet përkatëse.

9. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i miratuar për Universitetin Politeknik të Tiranës, pa efekte buxhetore shtesë.

10. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti Politeknik i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha